



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 899/ Prot

Tiranë, më 04/5/2022

VENDIM

Nr. 12, datë 04.5.2022

PËR

MOSPRANIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 (a) (i) të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Organizata Qëndresa Qytetare, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 899 Prot., datë 29.04.2022, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në cilësinë e kërkuarit, ankuesi, nëpërmjet kërkesës datë 14.04.2022, ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni mbi lidhur me:

1. Sa gjoha janë vendosur deri tani nga Bordi i Administrimit të Hidrokarbureve dhe Bordi i Transparencës së çmimeve të produkteve të shportës?
2. Cila është metodologjia e përcaktimit të çmimit tavan dhe sa është marzhi i fitimit mbi të cilin llogaritet çmimi tavan nga Bordet e krijuara nga Qeveria për hidrokarburet dhe çmimet e produkteve të shportës?
3. Ju lutem na vini në dispozicion emrat e anëtarëve të Bordit si më poshtë:
  - a. Ministrin përgjegjës për Financat dhe Ekonominë në cilësinë e kryetarit;
  - b. Ministrin përgjegjës për Bujqësinë;
  - c. Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve;
  - d. Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave;

- e. *Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;*
  - f. *6 (gjashtë) përfaqësues nga shoqëritë e tregtimit të produkteve;*
  - g. *1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat, në nivel drejtuesi të lartë;*
  - h. *1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për bujqësinë, në nivel drejtuesi të lartë.*
4. *Sa janë rezervat aktuale të drithërave të shtetit shqiptar? Sa është sasia e grurit që do të importohet nga Serbia dhe më çfarë çmimi?*
  5. *Po rezervat e hidrokarbureve (naftë), sa janë aktualisht?*

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, Komisioneri konstaton se ankesa, është depozituar pranë Zyrës së Komisionerit 1 (një) ditë pune, përpara përfundimit të afatit të vendosur në dispozicion për Autoritetin Publik për kthimin e përgjigjes, në kundërshtim kjo me pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilën përcaktohet se: “1. *Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe*”.

Gjithashtu, në pikën 2 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, parashikohet se: “*Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.*”

Sa më sipër, rezulton se nuk është përmbushur detyrimi për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga kushtet formale të nevojshëm për marrjen në shqyrtim të ankesave. Mosrespektimi i afatit të ankimit, përbën shkak për mos pranimin e ankesës.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjën a), i) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’ i ndryshuar,

## **V E N D O S A:**

1. Mospranimin e ankesës nr. 899 Prot., datë 29.04.2022 të Organizatës Qëndrore Qytetare, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, me

objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 04.5.2022.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

